



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 dhjetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe nenet 36(1) dhe (2) dhe 44 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”),² merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 29 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të paraqiste dosjen e vet paraprake brenda 17 dhjetorit 2021.³
2. Më 9 dhjetor 2021, ZPS-ja kërkoi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake t’i miratonte përdorimin e më së shumti 150.000 fjalëve në dosjen paraprake të saj (“Kërkesa”).⁴ ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për tejkalimin e kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve, sepse: (i) akuzat kundër të akuzuarave janë komplekse dhe mbulojnë një periudhë të konsiderueshme kohore si dhe kanë të bëjnë me qindra viktima; dhe (ii) ZPS-ja synon që në dosjen paraprake t’u referohet një numri të konsiderueshëm dëshmitarësh dhe provash materiale që janë nxjerrë në përputhje me rregullën 102(1) të Rregullores.⁵ ZPS-ja argumenton më tej se tejkalimi i numrit të lejuar të fjalëve do t’i mundësonte të paraqiste në mënyrë më të plotë përmbledhjen e provave të veta, çka do të ishte në të mirë dhe jo në dëm të këtij procesi gjyqësor.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSC-BD-15), 17 maj 2019.

³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 29 tetor 2021, publik, f. 752, rreshtat 23-25 deri në f. 753, rreshtat 1-2.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00598, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 9 dhjetor 2021, publike.

⁵ Kërkesa, para. 2.

⁶ Kërkesa, para. 3.

3. Në pajtim me nenin 44 të Udhëzuesit të Punës, në gjykimet me një numër të akuzuarish, dosja e përbashkët e procedurës paraprake duhet të ketë jo më shumë se 10.000 fjalë për rrethanat kontekstuale dhe jo më shumë se nga 10.000 fjalë për çdo të akuzuar.
4. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës në proces mund të kërkojë, paraprakisht dhe mjaftueshëm në kohë, tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, nëse tregon se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme.
5. Në pajtim me nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave, mocioni për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa i dhënë palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave mundësinë për t'u shprehur në lidhje me mocionin.

III. DISKUTIM

6. Pasi ka shqyrtuar arsyet e parashtruara nga ZPS-ja, në veçanti kompleksitetin e akuzave kundër të akuzuarve dhe sasinë e konsiderueshme të materialit të rregullës 102(1) të cilit ZPS-ja do t'i referohet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin tejkalimin e kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se Kërkesa është parashtruar paraprakisht në kohë të mjaftueshme, konkretisht një javë para afatit të ZPS-së për paraqitjen e dosjes paraprake.
7. Duke marrë parasysh se tejkalimi i numrit të lejuar të fjalëve do t'i mundësojë ZPS-së të paraqesë në mënyrë më të plotë përmbledhjen e provave të veta, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se miratimi i tejkalimit të numrit të lejuar të fjalëve apo nxjerrja e këtij vendimi para parashtrimit të përgjigjeve, nuk i shkakton asnjë dëm palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave.

8. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në 150.000 fjalë në dosjen paraprake të ZPS-së.

IV. VENDIM

9. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

MIRATON Kërkesën dhe autorizon tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në 150.000 fjalë në dosjen paraprake të ZPS-së.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 9 dhjetor 2021

Hagë, Holandë